

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR

DHE

MUZEUT KOMBËTAR TË KOSOVËS

Tiranë, 2021

Muzeu Historik Kombëtar (MHK), një institucion publik me adresë: Sheshi Skënderbej 7, Tiranë, Shqipëri, NIPT: J62202003N, përfaqësuar nga Dorian Koçi, Drejtor

Dhe

Muzeu Kombëtar i Kosovës (MKK), një institucion publik me adresë: Ibrahim Lutfiu, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Ajet Leci, Drejtor

Së bashku të përmendura më poshtë si palet:

bien dakord se qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi rregullon marrëdhëniet midis palëve me qëllim zbatimin e projekteve të përbashkëta, të cilat kanë për qëllim promovimin dhe përkujtimin e vlerave, ngjarjeve më të spikatura të historisë dhe të personaliteteve historike të popullit shqiptar.

Neni 1

Qëllimi

Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar i Kosovës dakordësohen në rëndësinë dhe dobinë e vendosjes së lidhjeve bashkëpunuese midis dy institucioneve, me qëllim përfitimin e ndërsjelltë midis dy institucioneve.

Neni 2

Bashkëpunimi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi kontribuon në përpjekjen e përbashkët me fokus trashëgiminë kulturore dhe kërkimin shkencor. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk lidh financiarisht apo ligjërisht asnjërën nga palët. Qëllimi i saj është të promovojë marrëdhëniet nga të cilat përfitojnë reciprokisht të dy institucionet, si qëllimi kryesor i bashkëpunimit.

Neni 3

Fushëveprimi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi shënon fillimin e bashkëpunimit midis palëve në të gjitha fushat dhe disiplinat me interes të përbashkët. Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar i Kosovës merren vesh paraprakisht për çdo veprimtari për përgjegjësitë e secilës lidhur me programin dhe preventivat e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore dhe atë të kërkimit shkencor.

Neni 4

Përgjegjësitë e palëve

1. Muzeu Kombëtar të Kosovës merr përsipër:

- a. bashkëpunimin me MHK, me qëllim përzgjedhjen e materialeve dokumentare, fotografike apo në forma të tjera, që do të ekspozohen pranë ambienteve të Muzeut Historik Kombëtar.
- b. bashkëpunimin me MHK me qëllim ofrimin në dispozicion të Muzeut Historik Kombëtar të materialeve muzeore, të cilat do të përzgjidhen nga specialistët e të dy institucioneve dhe do të shërbejnë në pasurimin e stendave të Muzeut Historik Kombëtar.
- c. bashkëpunimin me MHK për administrimin e materialit që do të ekspozohet dhe ndjekjen me përgjegjësi dhe profesionalizëm të procesit të hapjes së ekspozitave të përkohshme në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar dhe në Muzeun Kombëtar të Kosovës.

2. Muzeu Historik Kombëtar merr përsipër:

- a. bashkëpunimin me MKK me qëllim ofrimin e ambienteve dhe sallave për konferenca dhe ekspozita si edhe angazhimin për punimin grafik të artefakteve që do të ekspozohen.
- b. bashkëpunimin me MKK me qëllim mbajtjen e përgjegjësive për ruajtjen fizike dhe teknologjike, si dhe sigurimin e materialeve sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.
- c. bashkëpunimin me MKK me qëllim ofrimin në dispozicion të Muzeut Kombëtar të Kosovës të materialeve muzeore, të cilat do të përzgjidhen nga specialistët e të dy institucioneve dhe do të shërbejnë në pasurimin e stendave të Muzeut Kombëtar të Kosovës.

3. Përgjegjësitë e përbashkëta:

- a. MHK dhe MKK do të realizojnë projekte të përbashkëta për ngjarje, data e personalitete të historisë e kulturës tonë kombëtare.
- b. MHK dhe MKK do të organizojnë konferenca shkencore më fushën e muzeologjisë, të cilat do të ndikojnë në shkëmbimin e përvojës ndërmjet muzeologëve.
- c. MHK dhe MKK do të botojnë guida të përbashkëta me qëllim njohjen e ndërsjelltë të historisë dhe të kulturës së popullit tonë.

Neni 5

Shkëmbimi i botimeve

Me interes të veçantë do të jetë shkëmbimi i botimeve ndërmjet Muzeut Historik Kombëtar dhe Muzeut Kombëtar të Kosovës. Muzeu Historik Kombëtar do të ofrojë serinë e revistës Studime Muzeologjike, si dhe botime të tjera, ndërsa Muzeu Kombëtar i Kosovës do të ofrojë botimet e tij.

Neni 6

Aftësimi dhe shkëmbimi i kuadrit profesional

Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar i Kosovës marrin përsipër realizimin e trajnimit të specialistëve të dy institucioneve si edhe shkëmbimin reciprok të përvojave profesionale.

Neni 7

Ekspeditat shkencore

Muzeu Historik Kombëtar dhe Muzeu Kombëtar i Kosovës dhe do të organizojnë ekspedita të përbashkëta në fushën e trashëgimisë së luajtshme me pjesëmarrjen e specialistëve të dy institucioneve.

Neni 8

Përfaqësimet dhe garancitë

1. Në këtë marrëveshje palët përfaqësojnë dhe garantojnë sa më poshtë:
 - a. Ato kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë për të lidhur këtë marrëveshje bashkëpunimi;
 - b. Ato angazhohen për të ndërmarrë të gjitha veprimet për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi;
 - c. Ato angazhohen të punojnë së bashku drejt të njëjtit qëllim duke respektuar njëra-tjetrën dhe palët e treta të përfshira në aktivitete.

Neni 9

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përmban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë një viti kalendarik, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

Neni 10

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të

paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japin përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike.

2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin me njëra-tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve që duhet të ndërmerren bashkërisht rast pas rasti.

Neni 11 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim në përmbushjen e kushteve të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

Neni 12 **Hyrja në Fuqi**

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Muzeut Historik Kombëtar dhe dy pranë Muzeut Kombëtar të Kosovës.
2. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit të tij nga të gjitha Palët dhe protokollohet nga secili institucion.

Nënshkruar në Tiranë, më 27.11.2021.

PËR
MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

DREJTOR

Dr. Dorian KOÇI



PËR
MUZEUN KOMBËTAR TË KOSOVËS

DREJTOR

Ajet LEÇI

